

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-905 W

TRAJTIM IMPREGNIMI KUNDËR SALPETRIT DHE LAGËSHITISË QË NGURTËSOHET MBI SIPËRFAQË

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-905 W është impregnim rrëshire me bazë uji kundër lagështisë dhe gati për përdorim që ngurtësohet. Sikagard®-905 W është transparent pas tharjes. Sikagard®-905 W formon një barrierë fizike që parandalon rritjen e mykut dhe mikroorganizmave të tjerë.

PËRDORIMET

Sikagard®-905 W përdoret për parandalimin e lagështisë mbi sipërfaqet e suvatuara, me tulla ose gur. Për shkak të viskozitetit të tij, depërton thellë tek nënshtresa dhe formon një barrierë të tejdukshme kundër lagështisë dhe ujit.

- Trajtim salpetri
- Parandalim i rritjes së mykut duke reduktuar absorbimin e ujit
- Kundër lagështisë dhe forcues i sipërfaqes

Sikagard®-905 W përdoret si forcues i sipërfaqes për nënshtresat e dobëta dhe me pluhur, në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

Sikagard®-905 W mund të përdoret si trajtim paraprak përmirësues i sipërfaqeve për lyerjen mbi sipërfaqet e dobëta ose me pluhur.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Viskozitet shumë i ulët
- Pothuajse i padukshëm pas tharjes
- Mund të mbivishet me bojë ose letër muri
- Mund të përdoret në mjedise të brendshme e të jashtme
- Nuk përmban lëndë të parë biocide apo algacide
- Rezistent ndaj rrezeve UV

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|-----------------------|---|
| Ambalazhi | kovë 2 dhe 5 litra |
| Paraqitja / Ngjyra | Lëng ngjyrë qumështi |
| Jetëgjatësia | 12 muaj nga data e prodhimit, të ruhet në ambalazhin origjinal, i padëmtuar dhe i pahapur. |
| Kushtet e magazinimit | Të ruhet në kushte të thata, i mbrojtur nga ngrica në temperatura më të larta se +5°C. Të mbrohet nga nxehtësia e tepërt. |
| Dendësia | 1.01 kg/l |

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | |
|------------------------|---|
| Konsumimi | 0.2-0.3 l/m ² për veshje në varësi të porozitetit të nënshtresës |
| Temperatura e mjedisit | +5°C min. / +35°C max. |

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Përpara trajtimit, hiqni bojën ekzistuese, letrën e murit apo veshjen e murit që është dëmtuar nga lagështia. Hiqni cdo gjurmë të dukshme salpetri, myku apo mikroorganizmash të tjerë.

- Fërkoni me furçë të gjithë nënshtresën
- Shpëlani me ujë të freskët
- Lejoni tharjen sipërfaqësore të nënshtresës përpara aplikimit

PËRZIERJA

Sikagard®-905 W është gati për përdorim. Tundeni kovën përpara përdorimit.

APLIKIMI

Aplikoni Sikagard®-905 W me furçë ose rul për të siguruar ngopje të plotë të nënshtresës. Mbi nënshtresat shumë absorbuese mund të nevojitet një veshje e dytë. Lejoni veshjen e parë të thahet përpara se të aplikoni veshjen vijuese.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit.

KUFIZIME

- Sikagard®-905 W nuk parandalon dëmtimin nga kondensimi mbi muret e ftohta (p.sh. në dhoma me pak ajrosje).
- Sikagard®-905 W nuk mund të përdoret për të përmirësuar nënshtresat e shkatërruara që kërkojnë rinxjerrje të plotë të sipërfaqes (p.sh. suva i shkatëruar dhe i zbutur, etj.).
- Nëse nuk mbivishet, në rrethana në caktuara, Sikagard®-905 W mund të ndryshojë lehtësisht pamjen e sipërfaqes - kryeni gjithmonë testime paraprake përpara aplikimit të plotë.
- Sikagard®-905 W duhet të thahet plotësisht dhe të mos jetë i ngjithshëm përpara lyerjes apo vendosjes së letrës murale.
- Kur mbivishet me letër murale, përdorni adeziv letre për nënshtresa joabsorbuese.
- Kur mbivishet me letër murale që mund të lahet, përdorni adeziv rezistent ndaj mykut.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / g lloji wb) është 30 (Kufizimi 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikagard®-905 W është ~ 0.0 g/l për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikagard®-905 W
Mars 2019, Botimi 01.01
020406020020000014

Sikagard-905W-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf